



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

VENDIM

Nr. 123

Datë. 28 . 10 . 2021

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.
Dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-30.09.2021.**

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.137/2020 datë 16.12.2020, "Për buxhetin e vitit 2021".

Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1, 4, 5, 16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 28.01.2021 të Këshillit Bashkiak Korçë. "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë Korçë. Mbështetur në projekt-vendimin e paraqitur nga administratorët e sektorit të ndihmës Ekonomike, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

FONDI NË Lekë

1-Për muajin Shtator 2021, është në dispozicioni fondi prej 196.360 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit.

2- Nga ky fond, përfitojnë 51 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 117.880 lekë.

00 04130 02 Art. 2300000 +10,341,897 lekë (Programi Mbështetje e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Projekteve, Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Migracionit dhe Diasporës..
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi

